



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Proçes verbal

Sot me datë 24.06.2024 ora 13:00 ishte parashikuar mbledhja e **Kryesisë së Këshillit Bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak.

Të pranishëm janë:

Z. Oltion Luli

Znj. Irena Shala

Znj. Valjeta Bajraktari

Z. Gjergj Sokoli

Mungon:

Z. Blendi Gjylbegaj

Z. Edmond Ndou

Znj. Violeta Perndrecaj

Vijohet me citimin e rendin të ditës, që parashikohet për mbledhjen ardhshme të Këshillit Bashkiak, pjesë kjo që kryhet nga kryesia e Këshillit. Diskutohet mbi pikat e parashikuara të rendit të ditës, për të cilat kryetarët e grupeve bien të gjithë dakort. Diskutohet dhe bihet në dakortësi, që mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak do të mbahet të premten datë 28.06.2024 ora 17:00 me rend dite si më poshtë:

1. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Maj 2024"*.
2. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e listës shtesë të përfituesve dhe masën e subvencionimit të interesave të kredive për individë/familje që përfitojnë banesa me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti"*.
3. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Shkodër"*.
4. Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55 datë, 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar"*.



5. Pr/ Vendim: "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55 datë,29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar.

6. Pr/ Vendim: "Për dhënie mendimi për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndoturave".

7. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Zbardhi Proces verbalin:

Irma Sulishti

SEKRETAR

Sabina DANAJ

